REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 734/20
Datë/Datum. 30.09.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **SHËRBIMI KORREKTUES I KOSOVËS**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **33600-20-4032-1-1-1**

Sa i përket tenderit për **Furnizim me uniforma për stafin korrektues**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

ARTA TEX GROUP SHPK
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr Faik Konica nr. 17
(Adresa)

Pejë — *30000*
(Vendi) — (Kodi postar)

049/22 11 86 — *n/a*
(Numri Telefonit) — (Numri i Faks-it)

Armend Mustafa
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

Armendmustafa01@gmail.com
(Adresa elektronike)

30.09.2020
(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës].

Njoftimi për kontratë: 05.08.2020 me afat te shkurtuar qe dorëzimi ka qen ne te paren here 02.09.2020 por është shtyre duke ndryshuar kriteret e vlerësimit dhe specifikimet teknike.
Vendi i njoftimit, sistemi elektronik i tenderëve e-prokurimi.rks-gov.net
E prej datës 02.09.2020 është shtyre tri here afati dhe tashe se fundi nuk ka prite afatin e ankesave vetëm pse ne kemi bere Ankese si OE.
Afati i fundit per dorezimin e tenderit: 21.09.2020; Ora: 14:00
Kriteri për dhënie: Tenderi i pergjegjshem me çmimin më të ulët.
B54 Formulari standard per korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara 06.08.2020
B54 Formulari standard per korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara 13.08.2020
B54 Formulari standard per korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara 28.08.2020
B54 Formulari standard per korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara 04.09.2020
Vendim mbi pezullim të aktivitetit.pdf 01.09.2020 15:51
Lista e çmimeve per per furnizim me unforma per stafin ne SHKK -shqip e permirsuar.xlsx 03.09.2020 12:16
Vendim mbi pezullimin e aktivitetit.pdf 17.09.2020 13:40
Vendim mbi refuzim ARTA.pdf 21.09.2020 09:09
Një projekt te tille nuk është dashur te shpallet me afat te shkurtuar pasi kërkohet kohe e gjate me përgatit dosjen dhe mostrën qe është kërkuar ne dosje ka pasur shume kritere dhe shume mostra

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ **Jo** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] **Jo** ☐

Po, ne kemi bere kerkese per rishqyrtim pra AK,
Shërbimi Korrektues i Kosovës si AK ka bere shkelej te nenit 108A pasi ka bere pezullimin e Aktivitetit te Prokurimit me titull: Furnizim me uniforma për stafin" pasi ne si OE kemi bere kërkesën për Rishqyrtim me datën 16.09.2020.

Gjithashtu ky AK ne baze te ligjit është dashur pas Refuzimit te kërkesës sonë është dashur te beje ndërprerjen e pezullimit dhe ti njoftoj OE për dorëzim te ofertave apo shtyrje te afatit pasi nuk ka kaluar afati i ankesave i parapara me ligj te LPP-se pas refuzimit te Kërkesës për rishqyrtim.

Gjithashtu ne paragrafin e refuzimit te kërkesës per rishqyrtim KESHILLA JURIDIKE cek se çdo pale e interesuar mundet te parashtroj Ankese ne OSHP ne përputhje me nenin 109 dhe pas një procedure paraprake ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Kjo i bije qe po te jepi këshilla po une nuk ti respektoj këshillat e mija, e as OSHP-ne.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

AK i SHËRBIMI KORREKTUES I KOSOVËS ka bere shkelje te nenit 27/A Ndarja e Kontratave në llote
AK i SHËRBIMI KORREKTUES I KOSOVËS ka bere shkelje te nenit 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
AK i SHËRBIMI KORREKTUES I KOSOVËS ka bere shkelje te nenit 7 trajtimi i dhe bararazimi jo-diskriminimi pasi specifikat janë te përshtatur ndonjë OE dhe referencat.
AK i SHËRBIMI KORREKTUES I KOSOVËS ka bere shkelje te nenit 27 Dosja e Tenderit
AK i SHËRBIMI KORREKTUES I KOSOVËS **ka bere shkelje te nenit 28** pasi nuk ka bere specifikimin teknik te detajuar dhe sa me te gjere ku vërehen shume te meta ne

specifikime teknike.
AK i SHËRBIMI KORREKTUES I KOSOVËS **ka bere shkelje te parimeve te përgjithshme te prokurimit Kreut II te Ligjit te Prokurimit.**

AK i SHËRBIMI KORREKTUES I KOSOVËS **ka bere shkelje te nenit 10** Mjetet për promovimin e Transparencës –kufizim konkurrencës.
AK i SHËRBIMI KORREKTUES I KOSOVËS **ka bere shkelje te nenit 68** ekonomike dhe financiare
AK i SHËRBIMI KORREKTUES I KOSOVËS **ka bere shkelje te nenit 108A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve**
AK i SHËRBIMI KORREKTUES I KOSOVËS **ka bere shkelje te nenit Neni 109 Afatet për Dorëzimin e Ankesës**
AK i SHËRBIMI KORREKTUES I KOSOVËS **ka bere shkelje te Aneksit 1 te Dosjes se tenderit**

Përshkruaj specifikimet teknike, në mënyrë jo diskriminuese, karakteristikat e detyrueshme te objektit te kontratës siç janë: Kualiteti, sigurimi i kualitetit, performanca, terminologjia, kërkesat e dizajnit, simbolet, dimensionet, testimi dhe metodat e testimit, sigurimi, paketimi, shënjimi, etiketimi.

Specifikimet teknike duhet të përpilohen në mënyrë që të përputhen me qëllimin e prokurimit dhe të ofrojnë qasje sa më të madhe te operatorët ekonomik të interesuar.

Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar te vendosë specifikim teknik qe favorizojnë ose dis-favorizojnë një ose me shume operatorë ekonomik.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

1. Pretendimi 1 – Ak SHËRBIMI KORREKTUES I KOSOVËS ka ber shkeljen e nenit 27A të LPP-ës, pasi qe nuk e ka ndar tenderin ne lote pasi që në kete menyre siq eshte publikuar njoftimi per kontrate dhe dosja e tenderit eshte shkel ky nen i LPP-ës,
Neni 27, dhe 27/A dhe 28 pika 2 – AK per te rritur konkurrueshmerine duhet te ndaj tenderin ne lote dhe te mos pergatis kritere diskriminuese, ne kete rast kriteri me diskriminues ne kete aktivitet te prokurimit eshte mos ndarja ne lote, me qëllimin qdohere duke i mundesuar vetem nje OE qe te aplikoj dhe te fitoj kete tender, gjithashtu autoriteti kontraktues do t'i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik.
AK ka shkel nenin 1 te LPP-in 1 te LPP-ës pasi qe ne kete menyre duke mos e ndar

tenderin ne llote nuk siguron mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit fondeve publike.

Ne si OE me interes ne kete tender, kemi kerkuar nga AK qe te eliminoj kerkesen qe prodhuesi te jete i certifikuar me ISO 14001:2015 Sistem menaxhimi te mjedisit.

Ne si kompani prodhuese vendore i kesaj lamie, menaxhojme me ISO 9001:2015 Sistem i menaxhimit te cilesise, ndersa ISO 14001, nuk eshte aspak i nevojshem dhe kemi kerkuar qe te eliminohet per faktin se kjo kerkese eshte ne kundershtim me qellimin e tenderit dhe nuk eshte aspaki nevojshem per kete aktivitet te prokurimit.

1.Pretendimi 2- AK i SHËRBIMI KORREKTUES I KOSOVËS ka bere shkelje te nenit 108A pasi nuk ka bere pezullimin si qe kërkohet me paragrafin2 te nenit 108 A : po citojmë: *Dorëzimi i një kërkese për shqyrtim e obligon autoritetin përkatës kontraktues që automatikisht të pezulloj zbatimin e aktivitetit të prokurimit me të cilin ka të bëjë shkelja e pretenduar.*

Pretendim 3 AK i SHËRBIMI KORREKTUES I KOSOVËS *nuk ka shqyrtuar pretendimet tona Ankimore pasi ka bere kufizim te konkurrencës nuk ka bere specifikim te qarte te artikujve dhe nuk ka* ***ndare ne loto*** *pasi është vlere e madhe dhe me mundësuar* ***konkurrencën me shume****.*

Pretendim i ynë është se tri kërkesat për rishqyrtim qe kane dorëzuar OE nuk kane rishqyrtuar pretendimet për specifikime teknike qe kane pas OE edhe për kërkesa për shikim te produktit pasi nuk kane bere një specifikim te qarte te Uniformes dhe është kërkuar një **saivizit** por nuk ka lejua AK i Shërbimit Korrektues te Kosovës.

Diskriminim tjetër qe na është bere është se me datën 04.08.2020 ka qene dorëzimi i ofertave pra me afat te shkurtuar qe dorëzimi ka qen ne te paren here 02.09.2020 por është shtyre duke ndryshuar kriteret e vlerësimit dhe specifikimet teknike. Një projekt te tille nuk është dashur te shpallet me afat te shkurtuar pasi kërkohet kohe e gjate me përgatit dosjen dhe mostra qe është kërkuar ne dosje ka pasur shume kritere dhe shume mostra . E prej datës 02.09.2020 është shtyre tri here afati dhe tash se fundi nuk ka prite afatin e ankesave vetëm pse ne kemi bere Ankese si OE.

Pretendimi ynë – është bere diskriminim pasi nuk është bere specifikim teknik mire i detajuar dhe për këtë kemi bere kërkesën për rishqyrtim dhe ka përshtatjet kërkesave ndaj OE këtë mese miri tregon edhe mos ndërprerja e pezullimit dhe caktimi i afatit te dorëzimit te ofertave .

Gjithashtu këtë diskriminim tregon me se miri pasi nuk kane prit afatin **10 ditor te Ankesave ne OSHP.**

Gjithashtu ndryshimi i Specifikimeve teknike gjate fazës se tenderimit mbi 20 dokumente shto dokumente ndrysho dosje ndrysho listën kjo tregon se ju është përshtatur OE kriteret e vlerësimit dhe specifikat teknike

Specifikimet sipas nenit 28 Autoriteti kontraktues do t'i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime

teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik.

Specifikimet teknike do të formulohen ose duke iu referuar standardit të aplikueshëm, specifikimit, miratimit apo referencës teknike që kërkohet sipas paragrafit 4 dhe 5.

Autoriteti kontraktues do ti parashtrojë të gjitha specifikimet e detyrueshme teknike në dosjen e tenderit aktiviteti përkatës i prokurimit kërkon të parashtrojë specifikimet e tilla do të dërgojë një deklaratë të qartë që tregon se ku mund të merren specifikimet e tilla teknike

Pretendimi yni –është e pasi ka kërkuar ne dosjen e tenderit ti këtë qarkullim me vlere te madhe nëse do te ishte ndare ne loto ne i kishim përmbushur kushtin e kërkuar prej 1.000,000.00 euro . Një kërkesë e tille është diskriminuese qe te kërkohet kjo bije ndesh edhe me nenin 68 ekonomike dhe financiare te LPP - se por edhe me nenin 10 te LPP-se si dhe është kriter favorizues për këto dy kompani .

AK i **SHËRBIMI KORREKTUES I KOSOVËS** ***ka bere shkelje te nenit 109 te LPP-se dhe*** **nenin 108A pasi** nuk ka respektuar afatet kohore dhe nuk ka bere ndërprerjen e pezullimit dhe njoftimin e afatit për dorëzim te ofertave.

AK i **SHËRBIMI KORREKTUES I KOSOVËS ka vepruar ne kundërshtim me paragrafin 13 dhe 14 te nenit 108A te LPP-se po e citojmë paragrafin:**
13. Pavarësisht nga paragrafi 3 i këtij neni, miratimi i një refuzimi apo vendimi në përputhje me paragrafët 8 dhe 10 të këtij neni përfshin pezullimin e menjëhershëm të masave të miratuara sipas paragrafit 2 të këtij neni.

14.Kundër refuzimeve të miratuara sipas nën-paragrafëve 1, 2 dhe 3 të paragrafit 8 dhe vendimeve të marra sipas nën-paragrafëve 1 dhe 2 të paragrafit 10 të këtij neni, ankuesi ose ndonjë palë e interesuar, nëse ka, mund të paraqesë, në çdo rast, një ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109.

Gjithashtu nuk ka respektuar as paragrafin për Këshilla Juridike qe ceket se çdo pale ankuese ka te drejt te Ankohet ne OSHP ndërsa nuk ka prite afatin 10 ditor te parapara per Ankese. Një shkelje e tille është shume e rende. Po e Citoj nenin 109:

1.Kundër çdo vendimi të marrë nga autoriteti kontraktues në përputhje me rrethanat e nenit 108/A çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa duhet të dorëzohet vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji.

2.Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohen brenda dhjetë (10) ditëve pas vendimit të lëshuar nga autoriteti kontraktues në procedurën paraprake të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji.

Kërkoj nga OSHP-ja qe te Anuloj Rastin – tenderin dhe te kthej ne Ri tenderim pasi ka shume OE qe kane mbetur pa konkurruar pasi nuk ka pasur njoftim për ndërprerje te pezullimit dhe ne si OE kemi mbetur pa dorëzuar ofertën pasi kemi planifikuar me hy ne konzorcium nëse nuk ndryshohen kriteret e dosjes se tenderit pas Ankesave ne kemi përgatitur dokumentet për konzorcium.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Shpenzime te Avokatit **Shpenzime te mostrave** **Shpenzime të punëtoreve** **Etj**

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*